

PROCESVERBAL

Mledhja e 01 e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 29.01.2020 në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.
Në mledhje kanë marrë pjesë 14 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 01 të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020
4. Të ndryshme.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po 14

-Jo 0

-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbali u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diçka me shtu në rend te ditës nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime rendi i dites u pranua.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Për më tepër spjegime rreth kësaj pike fjalën ia japim Mentar Karjagdiut urdhëroni Z. Mentar.

Mentar KARYAGDIÛ: (Përfaqësues I OSBE-së)

Ju përshendes të gjithëve, sa I përket pregaditjes së këtij plani ne iu kemi drejtuar Kryetarit me një kërkesë dhe së bashku me kryetarin dhe anëtarët kemi mbajtur një drekë pune ku së bashku e kemi hartuar planin e punës së kuvendit për vitin 2020. Qëllimi I këtij plani është që tua lehtësojë punën për tërë vitin. Ky draft është I njëjtë edhe për vitet e ardhshme veq se kanë me ju ndërru pikat e rendit të ditës.

Krahasuar me vitin 2019 dallimi këtë vit është që plani e ka edhe parathënien ku thuhet që Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Në statut shkruan gjithqka. Sipas këtij plani Kuvendi i Komunës së Mamushës planifikon ti mbaj 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Në rast nevojë mund të mbahen edhe mledhje të jashtëzakonshme. Krahasuar me planin e vitit të kaluar në planin e vitit 2020 në qdo muaj I kemi vendosur nga dy pika siq janë shqyrtimi i informatave mbi çështjet e caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të kuvendit dhe shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal ku anëtarët e kuvendit kanë hapësirë dhe mundësi që të shtojnë ndonjë pikë ose propozim. Ndërsa tek pika e dytë siq morëm edhe informata nga Besirja që në muajin Mars Kuvendi duhet ta kalojë për votim planin komunal për menaxhim të mbeturinave dhe këtë e vendosim si pikë të rendit të ditës në muajin Mars. Për qdo muaj ka pika të ndryshme të rendit të ditës. Do ta shihni që në muajin Mars është raporti financiar për vitin 2019 ku ju si anëtarë të kuvendi keni të drejtë të kërkonit sqarime nga drejtori i Financave. Në muajin Prill qdo komunë pregadit informata për shpenzimet tre mujore financiare për periudhën Janar-Mars 2020 dhe diskutohet në kuvend. Sa I përket buxhetit qdo komunë në muajin Shtator duhet ta shqyrtoj dhe miratoj planin e buxhetit për vitet 2021-2023 dhe kjo është e vlefshme edhe për komunën e Mamushës. Ky është një draft plan, nëse keni diqka me shtu mundeni. Ky ishte një sqarim I shkurtër nga ana ime sa I përket planit të punës së kuvendit për vitin 2020. A ka dikush diqka me pyet rreth planit?

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

E falenderojmë Z. Mentar për sqarimin që na bëri, atëherë nëse nuk keni diqka me shtu ose me pyet rreth kësaj pike shkojmë në votim.

Me vota unanime u votua plani I punës së kuvendit për vitin 2020,

4.Të ndryshme

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet?

Halim SADÌKU:

Fjalët e mia janë standart, mbeturina, problem I kanalizimit dhe kto probleme unë I kam diskutuar edhe në komitetin për komunitete edhe në kuvend dhe po besoj që jam bërë I tepërt. Jus i komunë sat ë doni pastrojini por përderisa nuk ka inspektim prap do të hudhin. Drejtorët po flenë, përse nuk dalin në teren me shiku njëherë se qka po ndodhë? Shportat e mbeturinave po hiqen dhe në vend të tyre po vendosen shporta të reja, qdo gjë që e bëni mendojëni sikur jeni duke e bërë në shtëpinë tuaj . Ka problem me kubëza me ndrqim. Faleminderit.

Abdülhadi KRASNÏÇ Kryetar i Komunës së Mamushës:

Sa i përket gjendjes së sigurisë në Mamushë kohëve të fundit është mirë, kanë ndodhur disa raste të vjedhjeve para vitit të ri por mbrenda 2 javëve nuk ka asnjë rast. Para disa muajve ne kemi arritur ti aktivizojmë një pjesë të madhe të kamerave por kanë mbetur vetëm disa ku nuk janë instaluar kabllot dhe do ti instalojmë së shpejti. Policia kanë me i instalu kamerat ku ka nevojë, disa kamerave kanë me ju ndërru vendet. Pra jemi duke punuar në këtë drejtim dhe mendoj që nëse arrijmë ti funksionalizojmë kamerat do të zvogëlohet edhe numri i vjedhjeve. Mamusha është vend i vogël dhe prapë po ka raste të vjedhjeve por krahasuar me Prizrenin, Suharekën ka më pak raste. Faleminderit.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar. Faleminderit për pjesmarrje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek